



Shoqata Shqiptare e Dhimbjes Albanian Pain Association

Member of
European Federation of I.A.S.P (Chapter in formation)

Kryetar (President) - Dr. Apostol Vaso N/Kryetar (Vice President) - Dr. Hajri Gerbi
Sekretar (Secretary) - Dr. Artid Duni

Informacion i përgjithshëm mbi Shoqaten Shqiptare te Trajtimit te Dhimbjes.

Shoqata Shqiptare Dhimbjes është një organizatë profesionale mjekësore e themeluar në nëntor të vitit 2001. Objektivi kryesor i punës së shoqatës, është promovimi i trajtimit të dhimbjes kronike si një element thelbësor i rritjes së cilësisë së shërbimit dhe cilësisë së jetës.

Strategjia e shoqatës është të jetë sa më pranë problemeve që shqetësojnë komunitetin mjekësor dhe shoqërinë shqiptare nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në problematikën e përditshme për të qënë prezent në ndryshimet që ndodhin në sistemin tonë shëndetsor, kusht ky për implementimin e ideve dhe objektivave të shoqatës.

Që prej themelimit Shoqata Shqiptare e Trajtimit të Dhimbjes ka realizuar një aktivitet të rëndësishëm sensibilizues, edukativ dhe trainues me aktorë të ndryshëm si mjekë, punonjës sociale, psikologë, fizioterapistë, këshillues, si edhe në komunitet.

Shoqata Shqiptare e Dhimbjes deri tani ka organizuar me sukses pesë konferenca kombëtare të përvitshme dhe dy workshope, targeti i të cilave janë mjeku i përgjithshëm dhe aktorë e tjerë të shërbimit parësor si edhe të sëmurët me dhimbje kronike. Të gjitha këto aktivitete tashmë janë kthyer në një traditë.

Gjithashtu kjo shoqatë ka edhe periodikët e vetë të titulluar “DHIMBJA” dhe “MJEKESIA NE PRAKTIKE”. Këta periodikë janë të përdymuajshëm dhe përtremuajshëm dhe deri tani janë botuar pesë numra të tyre.

Vitin e kaluar, Shoqata Shqiptare e Trajtimit të Dhimbjes, organizoi aktivitete sensibilizuese, në kuadër të **Javës Evropiane kundër Dhimbjes te Gratë**, të cilat u realizuan nga data 21 deri më 27 tetor 2007.

Java Evropiane Kundër Dhimbjes te Gratë organizohet në bashkëpunim me **Komisionin European** dhe ka si synim sensibilizimin e intitucioneve dhe programeve të ndryshme për shërbimin publik, për përfshirjen në axhendën e politikave sociale dhe shëndetsore të **Trajtimit të Dhimbjes**.



Shoqata Shqiptare e Dhimbjes Albanian Pain Association

Member of
European Federation of I.A.S.P (Chapter in formation)

Kryetar (President) - Dr. Apostol Vaso N/Kryetar (Vice President) - Dr. Hajri Gerbi
Sekretar (Secretary) - Dr. Artid Duni

Qëllimi kryesor i aktiviteteve të Javës Europiane Kundër Dhimbjes, në Shqipëri është nxitja e iniciativave në nivel të një politike europiane, në qëndër të së cilës këtë vit do të jetë dhimbja te gratë dhe diagnozat e ndryshme të saj, të cilat shfaqen:

- Nga ana epidemiologjike: shumë situata klinike të dhimbjes janë ekskluzivisht për femrat si p.sh
 1. dismenoreja
 2. dhimbjet e lindjes
 3. dhimbjet e pas lindjes
 4. endometriozat

ose mund të jenë më të shpeshta te gratë se sa te burrat si p.sh.

1. Sindromi i zorrës së irrituar
 2. çistiti intersticial
 3. fibromyoalgjia
 4. migrena
 5. dhimbja tensive e kokës
- Nga ana simptomatologjike: diversiteti i paraqitjes së simptomave te gratë. Gratë shpesh e ankojnë dhimbjen krejt ndryshe nga burrat, duke i paraqitur diagnozat më të vështira p.sh. dhimbja e gjoksit tek ato paraqitet me variante të ndryshme dhe të paparashikueshme, me pasoja të rëndësishme në identifikimin e hershëm dhe si rrjedhojë trajtimin e përshtatshëm të situatave urgjente, të tilla si sëmundjet iskemike të zemrës.
 - Në aspektin diagnostik dhe kurativ: disa lloj dhimbjesh kuptohen si “normale” te gratë, ndryshe nga burrat dhe si rrjedhojë ngelen të patrajtuara ose të keqtrajtuara.
 - Në aspektin shoqëror dhe kulturor: ka diferenca të theksuara në sjelljen dhe kulturën e tyre dhe kjo bën që ato të kenë një larmishmëri të madhe në mënyrat si e kërkojnë ndihmën mjekësore.
 - Në aspektin e rezultateve të trajtimit: ka ndryshime ndërmjet burrave dhe grave në rezultatet e pritshme të trajtimit mjekësor.



Shoqata Shqiptare e Dhimbjes **Albanian Pain Association**

Member of
European Federation of I.A.S.P (Chapter in formation)

Kryetar (President) - Dr. Apostol Vaso N/Kryetar (Vice President) - Dr. Hajri Gerbi
Sekretar (Secretary) - Dr. Artid Duni

Ky fenomen do të trajtohet jo vetëm si një problem mjekësor, por duke i kushtuar vëmendje të veçantë dimensionit të gjerë social dhe ekonomik të tij në shoqëri, çka e bën të domosdoshme përfshirjen e dhimbjes së gruas dhe dhimbjen kronike në tërësi në strategjitë e ardhshme të politikave të Shtetit tonë për shëndetin publik dhe në atë të barazisë gjinore.

Java Kundër Dhimbjes në Shqipëri, u realizua nëpërmjet bashkëpunimit të antarëve të Shoqatës Shqiptare të Dhimbjes dhe Shoqatës “ Gruaja në Zhvillim”si edhe punonjësve të shërbimit social dhe shëndetsisë që përballen me dhimbjen, organizatave të ndryshme që përfaqësojnë të sëmurët me dhimbje, shoqatave, institutive, biznesit farmaceutik si dhe biznesit në përgjithësi, aktorë këta të ndjeshëm ndaj problemit të dhimbjes dhe sidomos dhimbjes kronike te gratë.

Personi i kontaktit:

Apostol Vaso, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Trajtimit të Dhimbjes,
Adresa: Rrg. Hodo Beg, Nr. 2,
Tel: 0 4 379 818, Mob. 068 3407185
email: revistadhimbja@yahoo.com